



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 21/ datë 29.03.2026

VENDIM I KËSHILLIT BASHKIAK
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.100, DATË 04.12.2025, PËR
MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, BASHKIA PËRMET, VITI
2026

Në mbështetje të nenit 54, shkronja "f", të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Paketës Fiskale të vitit 2026, miratuar me vendim nr.100, datë 04.12.2025, shkresës nr.91, datë 11.02.2026, për kryerjen e shërbimit të pastrimit me Bashkinë Përmet, Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të shtohet në paketën fiskale zërit si më poshtë:
 - 1.1. Tarifa e Pastrimit për pikën Doganore "Tre Urat" të jetë 200,000 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Tatim Taksave, Aseteve dhe Licencave pranë Bashkisë Përmet, Njësitë Administrative.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

Në mungesë dhe me porosi
Nënkryetari i Këshillit të Bashkisë Përmet
Agim ANDONI

